



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2021

VENDIM
Nr. 201, datë 12.05.2021

PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KUKËS

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, Ilir Përdeda, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen penale me Kërkues: Prokuroria; Të pandehur: Rezart Tahiri, Sali Kovaçi, Ramiz Cena, Beqir Murataj, Kreshnik Murataj, Pal Përgjegaj, Albert Tuci, Floriand Myftaraj, Zejnel Meçe, etj; Objekti: Kultivim i bimëve narkotike.

GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

1. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Gjyrokastër, Sokol Pina, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; Të pandehur: Astrit Balliu, Fatos Llaftiu, Iskender Sale, etj; Akuza: “Nenet 283/a/1, 28/4, 278/1, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal” (Dosja penale e ndarë nga dosja me të bashkëtëpandehur Altin Avdyli, Astrit Avdyli, Shkëlqim Avdyli si dhe e lidhru me dosjet penale me të pandehur, si dhe me dosjen penale me të pandehur Fisnik Sadiku).

GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Ridvan Hado (relator), gjyqtari i Gjykatës së Apelit Shkodër, Astrit Kalaja dhe gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, Iliba Bezati, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: Altin Bogdani, Vasillaq Vito; Akuza: Për kryerjen e veprave penale parashikuar nga nenet 259, 244 dhe 199/a/1 të Kodit Penal.

II. Një kopje e vendimit t'i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR